| Data | |
|---|---|
| Nr. | Prot. |

**RELACION**

**PËR**

**PROJEKTVENDIMIN**

**<u>MBI PËRDORIMIN E PORTALIT ELETRONIK (MODULIT) PËR PARTITË POLITIKE DHE SUBJEKTET ZGJEDHORE</u>**

## I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Neni 19, pikat 1, shkronja "n", e 2 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të ushtruar në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Në zbatim të neneve 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, 63, 64, 65, 67, 70 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, është hartuar projektvendimi "Mbi përdorimin e portalit elektronik (Modulit) për partitë politike dhe subjektet zgjedhore".

## II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Objekt i këtij projektvendimi është përftimi, administrimi dhe ruajtja nga KQZ e të dhënave mbi partitë politike dhe subjektet zgjedhore, nëpërmjet Portalit Elektronik për Partitë Politke (PEPP).
Nëpërmjet kësaj platforme do të përcaktohen si më poshtë:

- Mënyra e ngarkimit të të dhënavë të partisë në PEPP;
- Kërkesat për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor, për të propozuar anëtarë të komisioneve zgjedhore, të grupeve të numërimit, vëzhgues, apo kërkesa të do të paraqiten dhe të shqyrtohen nëpërmjet PEPP;

- Rregullat për përftimin, administrimin dhe ruajtjen e të dhënave për partitë politike, subjektet zgjedhor, për regjistrimin e tyre nëpërmjet PEPP, si dhe mbi shqyrtimin e kërkesave të ndryshme nëpërmjet kësaj platforme.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi "Mbi përdorimin e portalit elektronik (Modulit) për partitë politike dhe subjektet zgjedhore".

**Valbona BALLGJINI-**Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dheMonitorimit

**Majlinda ÇELMETA -** Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

**Ylli MERKAJ** **-** Sekretar i Përgjithshëm

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

| Data: | Nr: | Ora: |
|---|---|---|

**PROJEKTVENDIM**

**MBI**

**PËRDORIMIN E PORTALIT ELEKTRONIK (MODULIT) PËR PARTITË POLITIKE DHE SUBJEKTET ZGJEDHORE**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, 63, 64, 65, 67, 70 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

**V E N D O S:**

1. Të dhënat mbi partitë politike dhe subjektet zgjedhore përfitohen, administrohen dhe ruhen nga KQZ edhe nëpërmjet Portalit Elektronik (Modulit) për Partitë Politike (PEPP).
2. Çdo parti politike mund të ngarkojë të dhënat e saj në mënyrë të pavarur në PEPP.
3. Kërkesa për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor, për të propozuar anëtarë të komisioneve zgjedhore, të grupeve të numërimit, vëzhgues, apo kërkesa të tjera kur është rasti, mund të paraqiten dhe të shqyrtohen edhe nëpërmjet PEPP.
4. Rregullat për përftimin, administrimin dhe ruajtjen e të dhënave për partitë politike, subjektet zgjedhore, për regjistrimin e tyre nëpërmjet PEPP, si dhe mbi shqyrtimin e kërkesave të ndryshme nëpërmjet kësaj platforme, përcaktohen në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Lidhja nr 1

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
TIRANE

PORTALI I
PARTIVE POLITIKE

# RREGULLAT E PËRDORIMIT

Përmbajtja


*Përkufizime* ..... 4
*Hyrje* ..... 5
**HYRJE NË SISTEM** ..... **7**
**PARTI POLITIKE** ..... **10**
DASHBOARD ..... 14
TË DHËNA TË PËRGJITHSHME ..... 16
**TË DHËNAT E PARTISË** ..... 16
**ZGJEDHJE NË PROCES** ..... 17
**SUBJEKTET ZGJEDHORE** ..... 17
**1. REGJISTRIMET** ..... **20**
**1.1 REGJISTRIM I RI PËR SUBJEKT ZGJEDHOR** ..... 21
**1.1.1 REGJISTRIM NË PRITJE** ..... 26
**1.1.2 LISTA E REGJISTRIMEVE** ..... 28
**SUBJEKTI ZGJEDHOR** ..... 30
**1.2 REGJISTRIM KOALICIONI** ..... **32**
**1.2.1 REGJISTRIM I RI** ..... 32
**1.2.2 REGJISTRIME NË PRITJE** ..... 36
**1.2.3 LISTA E REGJISTRIMEVE** ..... 37
**KOALICIONI** ..... 39
**REGJISTRIM PËR DEPUTET** ..... 40
**REGJISTRIMET SIPAS QARQEVE** ..... 40
**REGJISTRIME TË PA DËRGUARA** ..... 52
**LISTA E PLOTË E REGJISTRIMEVE** ..... 57
**LISTA SHUMËEMËRORE TË MIRATUARA DEPUTET** ..... 60
**1.3 APLIKIME ANËTAR KZAZ** ..... **63**
**LISTA E PLOTË E PROPOZIMEVE** ..... 70
**LISTA E VENDIMEVE** ..... 72
**LISTA E PLOTË E ANËTARËVE** ..... 74
**ANËTARËT E KQV-VE** ..... 76
**LISTA E PLOTË E PROPOZIMEVE** ..... 81
**LISTA E VENDIMEVE** ..... 84
**LISTA E PLOTË E ANËTARËVE** ..... 86
**1.4 REGJISTRIM PËR KRYETAR BASHKIE** ..... **88**
**3.4.1 REGJISTRIM SIPAS BASHKIVE** ..... 88
**3.4.2 REGJISTRIME TË PA DËRGUARA** ..... 93
**LISTA E PLOTË E REGJISTRIMEVE** ..... 97
**LISTAT SHUMËEMËRORE TË MIRATUARA** ..... 99
**1.5 REGJISTRIM PËR KËSHILL BASHKIAK** ..... **101**
**1.5.1 REGJISTRIMET SIPAS BASHKIVE KËSHILL BASHKIAK** ..... 101
**REGJISTRIME TË PA DËRGUARA KËSHILL BASHKIAK** ..... 106
**LISTA E PLOTË E REGJISTRIMEVE KËSHILL BASHKIAK** ..... 112
**LISTAT SHUMËEMËRORE TË MIRATUARA KËSHILL BASHKIAK** ..... 115
**2. PËRDORUESIT** ..... **118**

KONFIGURIME ........ 121
**DASHBOARD ........ 128**
**TË DHËNAT E PËRGJITHSHME ........ 128**
**PËRDORUESIT ........ 130**
**FJALËKALIMI ........ 134**

# Përkufizime

Në këtë manual përdorimi termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

**D**

1. “Data e zgjedhjeve” është data e votimit, e caktuar me dekret të Presidentit të Republikës.

**K**

2. “Kandidat” është një shtetas shqiptar, i regjistruar si kandidat për deputet ose për kryetar bashkie, ose për këshillin e bashkisë, në përputhje me Kodin Zgjedhor, për të cilin do të votohet në zgjedhje.

3. “Koalicion” është grupimi i dy apo më shumë partive politike për të konkurruar së bashku në zgjedhje, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

4. “KQZ” është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili është institucioni shtetëror i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

5. “KZAZ” është Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, që ngrihet dhe funksionon në përputhje më Kodin Zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë dhe zgjedhjet vendore.

**L**

6. “Listë shumemërore” është lista e kandidatëve për deputetë ose për këshillat e bashkisë, e hartuar dhe e regjistruar në përputhje me Kodin Zgjedhor.

**P**

7. “Parti parlamentare” është partia politike që ka fituar dhe zotëron të paktën një vend në Kuvend nga zgjedhjet pararendëse.

8. “Parti politike” është një parti e regjistruar në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”.

9. “Përfaqësues i subjektit zgjedhor” është një person i autorizuar i subjektit zgjedhor për të përfaqësuar interesat e tyre dhe për të marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve zgjedhore, në emër dhe për llogari të subjektit zgjedhor.

**S**

10. “Subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me Kodin Zgjedhor.

11. “Zgjedhje të pjesshme” janë zgjedhjet që kryhen në një apo më shumë njësi të qeverisjes vendore për kryetarin e bashkisë ose për këshillin bashkiak, kur mbetet vakant posti i kryetarit të bashkisë ose kur shpërndahet para kohe këshilli bashkiak.

12. “Zgjedhje” janë votimet për Kuvendin, për njësitë e qeverisjes vendore dhe referendumet.

13. “Zonë zgjedhore” është ndarja administrativo-territoriale e qarkut për zgjedhjet në Kuvend dhe bashkia për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendor

# Hyrje

Nëpërmjet këtij manuali përdorimi, çdo aplikanti per subjekt zgjedhor apo çdo subjekti zgjedhor të miratuar, do i jepet mundësia e orientimit mbi përdorimin e portalit të partive.

Manuali përbëhet nga udhëzime të qarta, se si aplikantët për subjekt zgjedhor, subjektet zgjedhore, kandidatët e pavarur, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët për këshill bashkiak, të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në përmbajtje të Kodit Zgjedhor apo akteve nënligjore për të garuar në zgjedhje.

Gjithashtu specifikohen rregullat e ngarkimit të dokumentave në portal. Si dhe identifikohen organet përgjegjëse, të cilat disponojnë kompetencat për administrimin dhe vlerësimin e dokumentacioneve online.



# Seksioni 1: Hyrje në sistem

# Hyrje në sistem

Portali për aplikimin dhe administrimin e Subjekteve Zgjedhore, të cilat janë të regjistruara në portal ose do regjistrohen, nuk mund të aksesohet pa një llogari përdoruesi, i cili me anë të kredencialeve të sakta (email dhe passëord), duhet të identifikohet në mënyrë që të hyjë në portal.




Nëse këta aplikantë për subjekt zgjedhor, nuk kanë një llogari me kredencialet përkatëse, sistemi u jep mundësinë e aplikimit nga jashtë portalit, si parti politike dhe komitet nismëtar. Aplikimi nga jashtë portalit për subjekt zgjedhor, kryhet vetëm, për kategorinë e Komitetit Nismëtar.




Ndërsa për partinë politike, aplikimi jashtë portalit funksionon në këtë mënyrë:

**1. Parti Politike**

Fillimisht Partia Politike që të garojë në zgjedhje si subjekt zgjedhor, duhet të bëj aplikimin si parti politike jashtë portalit.

Në momentin që ajo aprovohet si parti politike, asaj do i jepen kredencialet për të aksesuar portalin. Në këtë moment partia politike e aprovuar, ka mundësi të bëjë aplikimin e ri si subjekt zgjedhor.

Pasi ky aplikim i ri të jetë miratuar si subjekt zgjedhor, partisë politike i jepet mundësia të bëjë aplikimet si: koalicion, aplikime pëe anëtar KZAZ, aplikime për anëtar KQV, aplikime për kryetar bashkie dhe aplikime për këshill bashkiak.

# Parti Politike

# Parti Politike

Për të aplikuar si subjekt zgjedhor, fillimisht ju duhet të bëni aplikimi si parti politike jashtë portalit.




Për të aksesuar formularin e aplikimit, klikoni mbi butonin "Krijo llogari si Parti Politike". Pasi të keni klikuar butonin, do ju shfaqet formulari i aplikimit:




Formulari i aplikimit është i ndarë në tri kategori:

1. Partia Politike, me të dhënat:

- Emërtimi (si emërtohet partia politike)
- Shkronjat nistore të saj

- NIPT
- Adresa

2. Kryetari i partisë (individi, i cili është zgjedhur apo emëruar në krye të organit politik), me të dhënat:

- Emri
- Mbiemri
- Telefoni
- Email
- Adresa

3. Aplikanti (individi, i cili plotëson të dhënat e formularit të aplikimit), me të dhënat:

- NID (plotësoni shifrat e numrit personal)
- Emri
- Mbiemri
- Dokument identifikimi (ngarkoni dokumentin, në formatin imazh apo atë pdf)
- Telefoni (vendosni numrin e telefonit )
- Email
- Adresa

**Dokumentacionin** e kërkuar duhet ta ngarkoni në formular në formatin pdf apo imazh.

- Vërtetim regjistrimi nga gjykata (vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë)
- Speciment i vules së partisë

Pasi të keni plotësuar të dhënat në formular, klikoni butonin "Dërgo" për ta dërguar formularin e aplikimit për shqyrtim dhe verifikim në KQZ ose butonin "Mbyll" për ta mbyllur formularin.

Nëse klikoni butonin "Dërgo", në numrin e telefonit, të cilin e deklaruat në formularin e aplikimit, do ju vijë një kod konfirmimi (verifikimi).




Kodi i verifikimit shërben si një hap sigurie, për të verifikuar nëse të dhënat e plotësuara në formular, i përkasin të njëjtit aplikant apo një individi të paautorizuar.

Vendosni kodin e verifikimit ose klikoni butonin “Kthehu” për t’u kthyer në faqen paraardhëse. Pasi të keni plotësuar shifrat e kodit të konfirmimit, klikoni butonin “Dërgo”.

Pas verifikimit të saktë të shifrave të kodit nga sistemi, shfaqet dhe mesazhi i suksesit për regjistrimin e aplikimit.




Regjistrimi i partisë politike u dërgua në KQZ. Pasi të bëhet verifikimi dhe shqyrtimi i regjistrimit dhe nëse ky regjistrim është korrekt, do ju dërgohen në Email kredencialet për të aksesuar portalin.

Klikoni butonin “Kthehu tek faqja kryesore” për t’u rikthyer në faqen hyrëse të portalit.

# Dashboard

Dashboard është menuja e parë e portalit.

Faqja shërben për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme të raporteve të shprehur në statistika numerike apo grafikë të aktivitetit të sistemit, si për shembull:

1. 🗐 Statistika në vlera numerike të:

   - **Regjistrimeve për deputet**

     1. Numri i regjistrimeve nëpër qarqe
     2. Numri i regjistrimeve totale
     3. Numri i regjistrimeve të pranuara

   - **Regjistrime për kryetar bashkie**

     1. Numri i regjistrimeve në bashki
     2. Numri i regjistrimeve totale
     3. Regjistrime të pranuara

   - **Regjistrime për këshill bashkiak**

     1. Numri i regjistrimeve në bashki
     2. Numri i regjistrimeve totale
     3. Regjistrime të pranuara

2. 🖼 Grafikë të statistikave të regjistrimeve për **"Regjistrime kandidatësh për deputet"** (regjistrime të pranuara, regjistrime të tjera) dhe **"Regjistrime kandidatësh për kryetar bashkie apo këshill bashkiak"** (regjistrime të pranuara, regjistrime të tjera).

Paraqitja e faqes së dashboard jepet si më poshtë:




*Figura 1: Faqja e dashboard-it.*

## Të dhëna të përgjithshme

Te dhënat e përgjithshme është menuja, e cila gjendet në pjesën hyrese të portalit. Në këtë menu jepen të dhënat dhe informacionet e përgjithshme të partisë tuaj, duke i aksesuar sipas nënmenuve:

- Të dhënat e partisë
- Zgjedhje në proces dhe
- Subjektet zgjedhore

(Në këto menu ju nuk keni mundësinë e veprimeve, vetëm atë të shkarkimit të dokumentave përkatës)

## Të dhënat e partisë




Nënmenuja e parë përshkruan të dhënat e partisë, ku përshkruhet dhe tregohet infomacion i përgjithshëm për**:**

- **Emërtimi** (emri i partisë tuaj)
- **Shkronjat nistore** (inicialet e partisë)
- **NIPT**
- **Kryetari** (individi i zgjedhur në krye të organit politik)
- **Regjistruar më**
- **Adresa**
- **Data e regjistrimit në platformë**
- **Data e pranimit në platformë**

Gjithashtu këtu ju keni mundësinë e konsultimit dhe shkarkimit të dokumentave kryesorë për partine tuaj, të cilat janë: **Vërtetimi i gjykatës dhe Specimenti i vulës**.

**! Dokumentat  mund t'i konsultoni duke klikuar mbi emërtimet e tyre ose t'i shkarkoni ato duke klikuar mbi butonin në të djathtë të emërtimit.**

## Zgjedhje në proces

Në nënmenunë e dytë ju keni mundësinë e aksesimit të informacionit për sa i përket zgjedhjes në proces. Këtu ju keni mundësinë të aksesoni informacione të tilla si:

- **Lloji i zgjedhjeve** (zgjedhje për kuvendin, zgjedhje për qeverisjen vendore, zgjedhje e pjesshme vendore)
- **Dt. e zgjedhjeve** (është data e votimit, e caktuar me dekret të Presidentit të Republikës)
- **Emërtimi i zgjedhjes**  (nëse janë lokale apo parlamentare, si dhe viti kur do mbahen këto zgjedhje)
- **Mandati** (periudha e zgjatjes së mandatit)




## Subjektet zgjedhore

Në nënmenunë e tretë ju keni mundësi të aksesoni të dhënat e subjektit zgjedhor të partisë suaj. Këto të dhëna janë të aksesueshme vetëm nëse partia juaj është miratuar si subjekt zgjedhor.



Këtu ju do të aksesoni të dhëna si:

- **Emërtimi** (emri i partisë)
- **Shkronjat instore** (inicialet)
- **NIPT**
- **Adresa**
- **Kryetari i partisë**
- **Përgjegjës komunikimi me KQZ**
- **Financieri**
- **Data e regjistrimit në platformë**

Gjithashtu këtu ju keni mundësinë e konsultimit dhe shkarkimit të dokumentave kryesorë për subjektin tuaj zgjedhor që janë:

- Vërtetim i gjykatës,
- Specimenti i vulës,
- Deklarata solemne,
- Llogaria bankare.

**! Dokumentat mund t'i konsultoni duke klikuar mbi emërtimet e tyre ose t'i shkarkoni ato duke klikuar mbi butonin në të djathtë të emërtimit.**

# Seksioni 2: Aplikimet

# 1. Regjistrimet

Moduli i dytë i portalit, është moduli i regjistrimeve. Menutë që ky modul përfshin skematizohen si më poshtë:




Duhet të keni parasysh që:

Permbajtja e secilës menu, për secilin përdorues, është e ndryshme. Kjo ndodh për shakak të statusit të përdoruesit, nëse është subjekt zgjedhor i miratuar apo nëse është parti politike, e cila është aprovuar si e tillë.

Për secilin nga rastet, shpjegimet e menuve përkatëse do jepen më poshtë.

## 1.1 Regjistrim i Ri për Subjekt Zgjedhor

Regjistrim i ri për subjekt zgjedhor, është nën menuja e parë, e cila gjendet në menunë e "Regjistrimeve për Subjekte Zgjedhore". Në këtë menu partita politike, e cila është aprovuar nga KQZ si parti politike, mund të krijojë një aplikim të ri si subjekt zgjedhor.

Ky aplikim i ri, kryhet konform Kodit Zgjedhor, i cili parashikon sipas Nenit 64:

**1. Çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve.**

Rastet e tjera të partive politike si :

- Parti politike, e cila është miratuar si subjekt zjedhor, nuk i jepet mundësia të bëjë një aplikim të ri.
- Partia politike, e cila ka një aplikim në pritje, ka mundësi vëtëm të konsultojë të dhënat e aplikimit.

### **Rasti 1:** Parti politike e aprovuar.

Në rastin e parë, partisë politike tashmë të regjistruar në portal si e tillë, do i jepet mundësia të bëjë një aplikim të ri për subjekt zgjedhor brenda portalit.

Pasi të klikoni menunë, do ju shfaqet formulari i aplikimit për subjekt zgjedhor.




Formulari ndahet në pesë kategori:

**Partia,** me të dhënat:

- Emërtimi i partisë (plotësohet si fushë automatikisht nga sistemi)
- Shkronjat nistore (plotësohet si fushë automatikisht nga sistemi)
- NIPT (plotësohet si fushë automatikisht nga sistemi)
- Adresa

**Kryetari i Partisë**, (individi, i cili është zgjedhur apo emëruar në krye të organit politik), me të dhënat:

- Emri
- Mbiemri
- Adresa

**Financier i Partisë**, me të dhënat:

- Emri
- Mbiemri
- Adresa

**Përgjegjës komunikimi me KQZ-në**, me të dhënat:

- Emri
- Mbiemri
- Adresa

## Dokumentat

- Vërtetimi i gjykatës
- Specimenti i vulës
- Deklatata solemne (Klikoni ikonën e informacionit, në të majtë të emërtimit të dokumentit, për të marrë informacione shtesë, se si hartohet një deklaratë solemne dhe për ta shkarkuar atë në formatin ëord)



PROTECTED VIEW Be careful—files from the Internet can contain viruses. Unless you need to edit, it's safer to stay in Protected View. Enable Editing

**Deklaratë e angazhimit për përkushtimin për të konkurruar në mënyrë të ndershme në zgjedhjet për______________________ të datës __/__/20___.** Model – 01

Bazuar në nenin 64, pika 2, germa "e", të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, në cilësinë e Kryetarit të Partisë Politike______________________, unë z./zj. ______________________

*(emri zyrtar i partisë)* *(emri i kryetarit/es të partisë)*

**DEKLAROJ**

Angazhimin solemn të Partisë ______________________, se pjesëtarët e strukturave drejtuese dhe administrative, të anëtarësisë, kandidatëve për deputetë/ drejtues/ anëtarë të organeve të qeverisjes vendore, deputetë/ drejtues/ anëtarë të organeve të qeverisjes vendore dhe gjithë strukturave të tjera të angazhuara nga subjekti në këto zgjedhje, funksionarë / ish funksionarë publik do të refuzojnë të marrin pjesë në praktikat të blerjes së votës, marrjes së financimeve apo përfitimeve të kundërligjshme, veçanërisht nga ato që vijnë nga aktivitete kriminale.

Angazhohemi të zbatojmë rregulla për të gjithë anëtarësinë, administratën dhe ndjekësit tanë që:
Të mos premtojnë/ ofrojmë/ japim para, mallra, shërbime dhe/ ose nxisim premtime për punësim apo trajtime të tjera të veçanta votuesve dhe/ të tjerëve, duke përfshirë familjet e votuesve apo komuniteteve të ndryshme apo të veprojmë në mënyrë të tillë që synohet të ndikojë, ose arsyeshëm pritet të ndikojë në mënyrën se si votuesit japin votën e tyre;

- Të zbatojmë parimet bazë të trashëgimisë zgjedhore europiane për votim universal, të barabartë, të lirë, të fshehtë, dhe të drejtpërdrejtë;
- Të respektojë të drejtat dhe liritë politike të shtetasve, organizatave, partive politike, për të promovuar dhe debatuar çështje politike;
- Të mos përfshihemi në praktika kërcënuese ose pengimi për të ushtruar të drejtën e votës dhe shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve.

Të bëjmë publike në kohë reale pranë KQZ-së dhe faqen zyrtare të subjektit tonë politik çfarëdolloj donacioni si dhe të refuzojmë dhurime në mjete monetare apo në natyrë që:

- Tejkalojnë limitin e përcaktuar për donacion;
- Janë kontribute në para apo në natyrë me prejardhje nga burime të ndaluara që përfshijnë edhe të ardhurat nga krimi, individë, kompani të huaja nga vende me origjinë të dyshimtë/ të parajsave fiskale;
- Janë donacione të cilat nënkuptojnë apo perceptohen si favorizime për dhënie kontrata publike, emërime në funksione publike apo përfitime të tjera që shkojnë në emër e për llogari të dhuruesit.

**Kryetari i Partisë**

______________________
(emër, mbiemër, firma)

SCREEN 1 OF 1 100%

- Llogaria bankare (Klikoni ikonën e informacionit, në të majtë të emërtimit të dokumentit, për të marrë informacione shtesë, dhe për ta shkarkuar atë në formatin ëord)


Model –

DEKLARATË E PARTISË POLITIKE

(plotëso emrin e Partisë politike)

për zgjedhjet ______________________, të datës ___.___.20___,

Bazuar në nenin 92/2 pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

Unë ________________ kryetari i partisë politike ose person i autorizuar prej tij, ______________________ deklaroj se kam hapur llogari të posaçme me numër ____________________ pranë Bankës ________________________.

Autorizoj Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe të ngarkuarit e saj për të marrë drejtpërdrejt nga banka të dhëna për të gjitha transaksionet e llogarisë.

Emër, mbiemër, firma

End of document

Pasi të keni plotësuar të dhënat e formularit, klikoni butonin "Ruaj" për të dërguar aplikimin në KQZ për shqyrtim dhe verifikim.

Pasi të keni dërguar formularin e aplikimit në KQZ, status i aplikimit tuaj do kalojë në pritje.




Nga ky moment ju vetëm mund të konsultoni të dhënat e aplikimit të bërë.

**Rasti 2:** **Parti politike, e cila ka një aplikim për subjekt zgjedhor në pritje.**

Në rastin e dytë, partisë politike, e cila e ka bërë një regjistrim të ri si subjekt zgjedhor dhe e ka dërguar këtë regjistrim për shqyrtim dhe verifikim, do i jepet mundësia vetëm ta konsultojë regjistrimin në pritje.




Për të konsultuar të dhënat e regjistrimit, klikoni mbi butonin “Konsulto regjistrimin”.

Pasi të klikoni butonin, do ju shfaqet formulari i regjistrimit me të dhënat e plotësuara, të cilat mund t’i konsultoni.




Të dhënat që ju mund të konsultoni kanë të bëjnë me: **Partinë, Kryetarin e partisë, Financierin, Përgjegjësin e kontaktit me KQZ**. Gjithashtu keni mundësi të konsultoni dhe shkarkoni në formatin pdf **dokumentat** e ngarkuara ne formular.

## Rasti 3: Partia politike, e cila është miratuar si subjekt zgjedhor.

Partia politike e cila është miratuar si subjekt zgjedhor, i jepet mundësia vetem e konsultimit të aplikimit të saj**.**




Për të konsultuar të dhënat e aplikimit të miratuar, klikoni mbi butonin "Konsulto subjektin".

Pasi të klikoni butonin, do ju shfaqen të dhënat e subjektit zgjedhor, të cilat mund t'i konsultoni.




Ju mund të konsultoni të **dhënat e subjektit zgjedhor**, si dhe të konsultoni apo shkarkoni **dokumentacionin** në formatin pdf.

### 1.1.1 Regjistrim në Pritje

Regjistrime në pritje është nën-menuja, e cila gjendet në menunë e regjistrimeve për subjektet zgjedhore. Këtu do shfaqen regjistrimet në pritje për subjekt zgjedhor që një parti politike ka bërë. Nëse partia politike nuk është subjekt zgjedhor (është e aprovuar thjesht si parti politike) apo partia politike është subjekt zgjedhor, do u afishohet mesazhi:

"Ju nuk keni një regjistrim në pritje"

Më poshtë analizohet vetëm rasti i një partie politike, e cila ka bërë një aplikim si subjekt zgjedhor, i cili është në statusin e pritjes.

#### Rasti 2: Partia politike, e cila ka një aplikim në pritje.

Për rastin e dytë në menunë "Aplikime në pritje", partisë politike do i shfaqet formulari i aplikimit i plotësuar, të cilin ajo e ka dërguar në KQZ për shqyrtim dhe verifikim.

Formulari do përmbajë të dhënat:




**Partia,** me të dhënat:

- Emërtimi
- Shkronjat nistore
- NIPT
- Adresa

**Kryetari i partisë**, me të dhënat:

- Emri
- Mbiemri
- Adresa

**Dokumentacionet:**

- Vërtetimi i gjykatës
- Specimenti i vulës

**Financieri**, me të dhënat:

- Emër
- Mbiemër
- Adresa

**Përgjegjësi i kontaktit me KQZ-në,** me të dhënat përkatëse:

- Emër
- Mbiemër
- Adresa

**Dokumentacionet:**

- Deklarata solemne
- Llogaria bankare

**! Dokumentat mund t'i konsultoni duke klikuar mbi emërtimet e tyre ose t'i shkarkoni ato duke klikuar mbi butonin në të djathtë të emërtimit.**

## 1.1.2 Lista e Regjistrimeve

Lista e regjistrimeve është menuja, e cila gjendet në modulin e administrimit në kategorinë e regjistrimeve për subjekte zgjedhore. Në këtë menu, shfaqen gjithë regjistrimet e bëra nga partia politike për subjekt zgjedhor, si ato regjistrime që janë në pritje, miratuar, refuzuar.

Pasi të klikoni menunë do ju shfaqet pamja e mëposhtme.




Informacione e regjistrimit, janë të strukturuara në formë tabelare ku kolonat e tabelës, përmbajnë të dhënat si:

**Data e aplikimit** (data e dërgimit të formularit të aplikimit në KQZ), **Emërtimi i parisë, Shkronjat nistore**, **Kryetari i partisë, Aplikanti, Përgjegjësi i kontaktit me KQZ, Statusi**, si dhe ndiqen nga kolona **Veprime**, në të cilën:

- Bëhet konsultimi i të dhënave të regjistrimit.

## Konsultimi 👁

Për të konsultuar të dhënat e aplikimit, klikoni mbi butonin "Konsulto" të kolonës veprime. Pasi të keni klikuar butonin, do ju shfaqet formulari i aplikimit, me të dhënat.




**Partia,** me të dhënat:

- Emërtimi
- Shkronjat nistore
- NIPT
- Adresa

**Kryetari i partisë**, me të dhënat:

- Emri
- Mbiemri
- Adresa

**Dokumentacionet:**

- Vërtetimi i gjykatës
- Specimenti i vulës

Për të konsultuar të dhënat e dokumentave, klikoni mbi emërtimet e tyre. Dokumentat do ju hapen në formatin pdf, si dhe mund t'i shkarkoni si të tilla.

**Financieri**, me të dhënat:

- Emër
- Mbiemër

- Adresa

**Përgjegjësi i komunikimit me KQZ-në,** me të dhënat përkatëse:

- Emër
- Mbiemër
- Adresa

**Dokumentacionet:**

- Deklarata solemne
- Llogaria bankare

Për të konsultuar të dhënat e dokumentave, klikoni mbi emërtimet e tyre. Dokumentat do ju hapen në formatin pdf, si dhe mund t'i shkarkoni si të tilla.

# Subjekti Zgjedhor

Subjekti Zgjedhor është nën-menuja e fundit e menusë "Regjistrime për Subjekt Zgjedhor". Në këtë menu, partia politike e aprovuar si subjekt zgjedhor, ka mundësi të konsultojë të dënat e subjektit zgjedhor.

Pasi të klikoni menunë, do ju shfaqet pamja e mëposhtme.




Do ju shfaqen të dhëna si:

1. **Të dhënat e subjektit**

- Regjistruar më (data e regjistrimit të aprovimit për subjektin zgjedhor )
- Emërtimi
- Shkronjat nistore (inicialet)
- NIPT
- Adresa

- Kryetari i partisë (individi i zgjedhur në krye të organit politik)
- Përgjegjësi i komunikimit me KQZ
- Financieri

2. **Dokumente**

- Vërtetimi i gjykatës (vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë)
- Specimenti i vulës
- Deklarata solemne (deklaratën me shkrim të nënshkruar nga kryetari i partisë politike ku përmendet angazhimi solemn për refuzimin për të marrë pjesë në praktika të blerjes së votës, marrjes së financimeve apo përfitimeve të kundërligjshme, veçanërisht nga ato që vijnë nga aktivitete kriminale, si dhe përkushtimin për të konkurruar në zgjedhje në mënyrë të ndershme dhe me integritet. Teksti i deklaratës përcaktohet nga KQZ-ja.)
- Llogaria bankare

**! Për të parë dokumentin klikoni mbi emërtimin e tij, ndërsa për ta shkarkuar klikoni butonin në të djathtë të dokumentit.**

## 1.2 Regjistrim Koalicioni

### 1.2.1 Regjistrim i Ri

“Regjistrim i ri për Koalicion” është nën-menuja, e cila gjendet në menunë e aplikimeve për koalicion.

Në këtë menu, aksesin për të kryer veprime regjistrimi apo konsultimi, i jepen vetëm partisë politike, e cila është miratuar si subjekt zgjedhor. Sepse sipas Kodit Zgjedhor:

**1. Dy ose më shumë parti politike <u>të regjistruara si subjekte zgjedhore</u> në KQZ,**

**sipas nenit 64 të këtij Kodi, mund të regjistrohen në KQZ si koalicion zgjedhor në shkallë vendi jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve**

Rastet e tjera si:

**Rasti 1: Partia politike e aprovuar si e tillë.**

**Rasti 2: Partia politike, e cila ka një regjistrim për subjet zgjedhor në pritje.**

Nuk kanë të drejta të bëjnë aplikime si koalicion, sepse nuk janë subjekte zgjedhore.




**Rasti 3: Partia politike, e cila është miratuar si subjekt zgjedhor.**

Për të bërë aplikimin si koalicion, subjekti zgjedhor i miratuar duhet të plotësojë të dhënat te formulari i aplikimit.




**Figura 2: Të dhënat e Koalicionit.**

Pjesa e parë e formularit përbehet nga kategoria

**Koalicioni,** i cili përmban fushat:

- Emërtmi
- Shkronjat nistore. Vendosni emërtimin e koalicionin si do e quani dhe shkronjat nistore të tij.
- Logo e koalicionit (ngarkoni imazhin e logos)

Kujdes!

Fushat nuk duhen lënë boshe, pasi nuk mund të regjistroni formularin.

**Partia Lider**, del si fushe e plotësuar automatikisht nga sistemi.

Me të dhënat:

- Partia Lider (emërtimi)
- Inicialet
- Kryetari (individi i zgjedhur për të drejtuar organin politik)



Figura 3: Partitë e tjera pjesëmarrëse në koalicion.

Pjesa e dytë, përbehet nga kategoria **Partitë e tjera** dhe **Marrëveshja**.

Në kategorinë **Partitë e tjera** do të gjeni butonin "Shto parti", i cili ju jep mundësinë të shtoni partitë e tjera per t'u bërë pjesë e koalicionit.

Pasi të klikoni butonin, do ju shfaqet pamja:




Figura 4: Partitë politike për koalicion zgjedhor.

Duhet të bëni check në kolonën e fundit të tabelës, për të zgjedhur partinë politike për të formuar koalicionin zgjedhor.

Për secilën parti, lista mban të dhënat si: Emërtimi, Shkronjat nistore, Kryetari, Zgjedhur (checkoni kutinë për të përzgjedhur partinë).



Figura 5: Paritë politike të zgjedhura për koalicion.

Pasi të keni zgjedhur dhe check-u bëhet gri, do ju shfaqet pamja e mëposhtme:



Figura 6: Fshirja e partive të zgjedhura për Koalicion

Do ju dalin të gjitha partitë e zgjedhura, gjithashtu ju jepet mundësia të fshini ose jo partinë që dëshironi.

- Kategoria **Marrëveshja**, është fusha ku ju duhet të ngarkoni dokumentin e marrëveshjes midis partive.

Ky dokument në përmbajtjen e tij duhet të ketë të specifikuar marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre.

Klikoni butonin “Ruaj” nëse doni të dërgoni aplikimin në KQZ për shqyrtim dhe verifikim ose butonin “Pastro” për të fshirë të dhënat e plotësuara nga formulari.

Pasi të keni klikuar butonin “Ruaj”, do ju shfaqet dhe mesazhi i suksesit për regjistrimin e aplikimit.




Klikoni butonin “Shko tek lista ”, për t’u kthyer në listën e aplikimeve në pritje.

## 1.2.2 Regjistrime në Pritje

Regjistrime në Pritje është kategoria që do të gjeni pas menusë “Regjistrimi i Ri”. Pasi partia politike e miratuar si subjekt zgjedhor të ketë plotësuar formularin për të aplikuar si koalicion, ky regjistrim do shfaqet në listën e regjistrimeve në pritje. Pasi të klikoni menunë, do ju shfaqet formulari i plotësuar i regjistrimit.




**Figura 7: Aplikimet në pritje Koalicion.**

Formulari përman të dhënat e aplikimit në pritje si:

**Koalicioni**, me të dhënat: Emërtimi, Shkronjat nistore, Logo.

**Partia Lider**, me të dhënat: Emërtimi, Shkronjat nistore, Kryetari, Logoja e partisë.

**Partitë mbështetëse**, me të dhënat: Partia mbështetëse (emërtimet e tyre), Shkronjat nistore, Kryetari.

**Marrëveshja**, përmban dokument të cilin mund ta konsultoni duke klikuar mbi emërtimin e tij, si dhe ta shkarkoni duke klikuar mbi butonin në të djathtë të emërtimit.

### 1.2.3 Lista e Regjistrimeve

Lista e regjistrimeve është menuja e fundit që gjendet në menunë e aplikimeve për koalicion. Kjo menu përmban listën e rehjistrimeve që partia e miratuar si subjekt zgjedhor, ka bërë si koalicion. Pasi të klikoni menunë, do ju shfaqet pamja:




**Figura 8: Lista e aplikimeve Koalicion.**

Tabela e shfaqur përmban informacionin e strukturuar me të dhënat përkatëse për regjistrimet si: **Emërtimi i koalicionit, Shkronjat Nistore të koalicionit, Partitë mbështetëse, Statusi** (nëse aplikimi është në pritje për t'u regjistruar, regjistruar, refuzuar regjistrimi, në pritje për t'u miratuar, miratuar, refuzuar miratimi)**, Data e aplikimit (**data e dërgimit pranë KQZ të formularit të aplikimit**), Statusi (**në pritje, refuzuar, aprovuar**)** si edhe ndiqet nga kolona **Veprime** ku ju si përdorues i sistemit mund të konsultoni një aplikim të caktuar.

# Konsultimi 👁

Pasi të keni klikuar në butonin "Konsulto" të kolonës **Veprime,** do ju shfaqet pamja.



Figura 9: Të dhënat e aplikimit.

Formulari përman të dhënat e regjistrimit në pritje si:

**Koalicioni**, me të dhënat: Emërtimi, Shkronjat nistore, Logo.

**Partia Lider**, me të dhënat: Emërtimi, Shkronjat nistore, Kryetari, Logoja e partisë.

**Partitë mbështetëse**, me të dhënat: Partia mbështetëse (emërtimet e tyre), Shkronjat nistore, Kryetari.

**Dokumenti i marrëveshjes**, përmban dokumentin, të cilin mund ta shkarkoni për ta konsultuar.

(Për të parë dokumentin klikoni mbi emërtimin e tij, ndërsa për ta shkarkuar klikoni butonin në të djathtë të dokumentit)

# Koalicioni

Koalicioni është nën-menuja e fundit e menusë ”Regjistrimeve për koalicion”. Në këtë menu subjektit zgjedhor, të cilit i është aprovuar regjistrimi për koalicion, do i shfaqen të dhënat e koalicionit. Pasi të klikoni menunë, do ju shfaqet pamja e mëposhtme.




Do ju shfaqen të dhënat si:

**Koalicioni**, me të dhënat: Emërtimi, Shkronjat nistore, Logo.

**Partia Lider**, me të dhënat: Emërtimi, Shkronjat nistore, Kryetari, Logoja e partisë.

**Partitë mbështetëse**, me të dhënat: Partia mbështetëse (emërtimet e tyre), Shkronjat nistore, Kryetari.

**Dokumenti i marrëveshjes**, përmban dokumentin, të cilin mund ta shkarkoni për ta konsultuar.

(Për të parë dokumentin klikoni mbi emërtimin e tij, ndërsa për ta shkarkuar klikoni butonin në të djathtë të dokumentit)

## Regjistrim për Deputet

Regjistrim për deputet është menuja, e cila gjendet në modulin e regjistrimeve. Në këtë menu ju keni mundësi të bëni regjistrime të reja për deputet, të modifikoni regjistrimet e pa dërguara, si dhe të konsultoni regjistrimet e dërguara në KQZ për shqyrtim dhe verifikim.

Duhet të keni parasysh, se:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë përbëhet nga 140 deputetë, të cilët zgjidhen për një periudhë 4 vjeçare. Sistemi i zgjedhjeve për Kuvendin është sistemi proporcional me zona zgjedhore shumëemërore. Kriteret dhe rregullat për zbatimin e sistemit zgjedhor proporcional, për caktimin e zonave zgjedhore dhe për numrin e mandateve për secilën zonë, përcaktohen në Kodin Zgjedhor.

Kjo menu përbëhet nga katër nën-menu të tjera:

## Regjistrimet sipas Qarqeve

Regjistrimet sipas qarqeve është nën menuja e parë e menusë "Regjistrime për Dëputet". Në këtë menu ju jepet mundësia, të konsultoni një regjistrim, të modifikoni të dhënat e një regjistrimi të pa dërguar në KQZ, të shtoni një regjistrim të ri, si dhe të fshini një regjistrim të zgjedhur.

Pasi të klikoni menunë, do ju shfaqet pamja e mëposhtme:




Regjistrimet sipas 12 (dymbëdhjetë) qarqeve janë strukturuar në formë tabelare, ku kolonat e tabelës, përmbajnë të dhënat si:

**Qarku, Nr. i mandateve, Filluar** (nëse formulari i regjistrimit ka filluar të plotësohet apo jo), **Pa dërguar** (nëse regjistrimi nuk është dërguar për shqyrtim dhe verifikim), **Statusi** (pa dërguar, aprovuar, refuzuar), si dhe ndiqen nga kolona **Veprime,** e cila sipas butonit përkatës ju jep mundësinë:

- Të konsultoni regjistrimin, duke klikuar butonin "Konsulto"
- Të modifikoni regjistrimin, duke klikuar butonin "Modifiko"
- Të krijoni një regjistrim të ri, duke klikuar butonin "Krijo të ri"
- Të krijoni një regjistrim të ri nga regjistrimi ekzistues, duke klikuar butonin "Krijo të ri nga ekzistruesi"

Në pjesën e sipërme të tabelës keni të paraqitur filtrat e kërkimit, të cilët do ju japin mundësinë të bëni një kërkim më specifik, sipas **Qarkut** (zgjidhni një nga dymbëdhjetë qarqet), **Filluar** (PO – nëse është filluar plotësimi i formularit të regjistrimit ose JO – nëse formulari i regjistrimit nuk ka filluar të plotësohet), **Dërguar** (zgjidhni "Dërguar" nëse formulari i regjistrimit është dërguar në KQZ ose Pa dërguar, nëse formulari i regjistrimit nuk është dërguar në KQZ për shqyrtim dhe verifikim ). Pasi të keni plotësuar fushat e filtrave të kërkimit, klikoni butonin "Kërko" për të marrë rezultatet e dëshiruara.

## Konsulto Regjistrimin

Për të konsultuar regjistrimin, klikoni butonin "Konsulto" të kolonës Veprime. Pasi të klikoni butonin, do ju shfaqet pamja e mëposhtme:




Informacionet rreth regjistrimit, ndahen në dy kategori:

1. **Të dhënat e listës së kandidatëve**

- Qarku
- Numri i mandateve
- Statusi i regjistrimit (në pritje, aprovuar, refuzuar. pa dërguar)
- Data e krijimit (data e krijimit të regjistrimit)
- Data e dërgimit (data e dërgimit të regjistrimit në KQZ)
- Dërguar

2. **Kandidatët**

Informacionet për listën e kandidatëve janë strukturuar në formë tabelare ku kolonat e tabelës, përmbajnë të dhënat, si: **Emri, Mbiemri, Atësia, Mëmësia, Gjinia, Datëlidnja, Vendlindja, Subjekti politik**, si dhe ndiqen nga kolona **Veprime,** e cila ju jep mundësinë e konsultimit të të dhënave për kandidatin e listës.

### Konsulto të dhënat e kandidatit

Pasi të keni klikuar butonin “Konsulto”, do ju shfaqen dhe të dhënat personale të kandidatit.




Të dhëna si:

- Emri
- Mbiemri
- NID i kandidatit
- Letërnjoftimi
- Foto e kandidatit
- Atësia e kandidatit
- Mëmësia e kandidatit
- Datëlindja e kandidatit
- Gjinia e kandidatit
- Vendlindja e kandidatit
- Vendbanimi i kandidatit
- IBAN
- Deklarata e kandidatit
- Jetëshkrimi i kandidatit
- Formulari i vetëdeklarimit

**! Dokumentacionin e ngarkuar në formular mund ta konsultoni duke klikuar mbi emërtimin e dokumentave ose mund ta shkarkoni duke klikuar butonin e shkarkimit në të djathtë.**

## Modifiko regjistrimin ✍

Një regjistrim mbetet i pa dërguar dhe mund të modifikohet, nëse:

1. Nuk ka kandidatë të shtuar në listë
2. Të dhënat e kandidatëve nuk janë plotësuar si duhen

Pasi të klikoni butonin "Modifiko" të kolonës Veprime, do ju shfaqet pamja e mëposhtme:



Do ju shfaqen të dhënat si:

**1. Të dhënat e listës së kandidatëve**

- Qarku
- Numri i mandateve
- Dërguar

**2. Kandidatët**

Informacionet për listën e kandidatëve janë strukturuar në formë tabelare ku kolonat e tabelës, përmbajnë të dhënat, si: **Emri, Mbiemri, Atësia, Mëmësia, Gjinia, Datëlindja**, **Vendlindja, Subjekti politik**, si dhe ndiqen nga kolona **Veprime**, e cila ju jep mundësinë të modifikoni të dhënat e kandidatit ose ta fshini atë nga lista.

1. Nëse klikoni butonin e modifikimit do ju shfaqet formulari i regjistrimit për kandidatin me të dhëna pjesërisht të plotësuara.



Shtoni të dhënat që mungojnë apo modifikoni të dhënat ekzistuese dhe më pas klikoni butonin “Ruaj” për të ruajtur ndryshimet e bëra. Klikoni butonin “Mbyll” nëse nuk doni të ruani ndryshimet.

2. Fshini kandidatin nga lista duke klikuar butonin “Fshi”



Pasi të keni klikuar butonin “Fshi”, do ju shfaqet dhe dritarja me mesazhin e sigurisë, nëse doni ta fshini apo jo kandidatin nga lista. Klikoni butonin Po nëse doni ta fshini kandidatin nga lista ose jo për të mbyllur dritaren e sigurisë.

3. Gjithashtu ju jepet mundësia e shtimit të një kandidati të ri në listë, duke klikuar butonin “Shto kandidat në listë”.




Plotësoni formularin e regjistrimit dhe më pas klikoni butonin "Ruaj" për të shtuar kandidatin në listë ose butonin "Mbyll" për të mbyllur formularin dhe për t'u kthyer tek faqja paraardhëse.

Pasi të keni bërë modifikimet e dëshiruara në mënyrë korrekte, butoni "Dërgo" aktivizohet dhe ju jepet mundësia ta dërgoni regjistrimin në KQZ.




Klikoni butonin "Dërgo" nëse doni ta dërgoni regjistrimin në KQZ ose butonin "Fshi gjithë listën" për të fshirë kandidatët nga lista.

Pasi të dërgoni regjistrimin, do ju shfaqet dhe mesazhi i suksesit: "Regjistrimi u dërgua me sukses"

## Krijo regjistrim të ri +

